



## Udhëzues për plotësimin e LIBRIT TË BLERJES me TVSH

**Data:** Shëno datën e faturës. Formati duhet të jetë: data / muaji / viti, p.sh. 15.01.2023. Kjo rubrikë është mandatore.

**Numri i faturës:** Shëno numrin e faturës së shitjes. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

**Emri i shitësit:** Shëno emrin e plotë të shitësit nga i cili është furnizuar blerësi, p.sh.. "XXXXX" SH.P.K. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

**Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit / Numri Fiskal / Numri Personal:** Shëno Numrin Unik të Regjistrimit të Biznesit– Shitësit, Numrin Fiskal të shitësit apo Numrin Personal . Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit – formati është 9 shifror, fillon me 81... dhe përmban vetëm numra (personi i regjistruar në ARBK). Numri Fiskal - formati është 9 shifror, fillon me 6... dhe përmban vetëm numra ( personi i regjistruar në ATK); Numri Personal – formati është 10 shifror, fillon me 1... apo me 2... dhe përmban vetëm numra (personi i regjistruar në ARC). Në rastet kur blerjet janë nga Importet dhe kur ka të bëjë me Rregullimet për të ulur TVSH për pagesë duhet të vendosen numrat sipas tabelës së mëposhtme. Kjo rubrikë është e validueshme dhe është rubrikë mandatore.

Në vijim gjeni sqarimet se si duhet të plotësohet kolona e NUI / NF / NP:

LIBRI I BLERJES	
Vendosja e Numrit në Kolonën e NUI/NF/NP	Përshkrimi
81XXXXXXXX	NUI me 81... vendoset për Blerjet nga personat e regjistruar në ARBK.
60XXXXXXXX	NF me 6... vendoset për Blerjet nga personat që janë të regjistruar në ATK.
1XXXXXXXXX apo 2XXXXXXXXX	Numri Personal me 1....apo 2... vendoset për Blerjet nga personat fizikë jo-afaristë.
8	Numri 8 vendoset për Importet. Pra vendoset nëse plotësohen ndonjëra nga rubrikat, si: 31; 32; 33; 34; 35; 37; 39; 65 dhe 41.
9	Numri 9 vendoset për Rregullimet për të ulur TVSH për pagesë me 18%, pra nëse plotësohet rubrika 61.
10	Numri 10 vendoset për Rregullimet për të ulur TVSH për pagesë me 8%, pra nëse plotësohet rubrika 63.
11	Numri 11 vendoset për Shpenzimet jashtë vendit.
0	Zero vendoset në rastet kur Libri i Blerjes deklarohet pa transaksione, pra deklarimi i librit me zero.

**Numri i TVSH-së së shitësit:** Shëno numrin e TVSH-së së shitësit. Formati është 9 shifror, fillon me 3 dhe përmban vetëm numra (p.sh. 330000001). Validohet sipas Numrit të TVSH-së, nuk është rubrikë mandatore.

**[31] Blerjet dhe importet pa TVSH:** Shëno blerjet vendore dhe importet që nuk janë të ngarkueshme me TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[32] Blerjet dhe importet investive pa TVSH:** Shëno blerjet vendore dhe importet që konsiderohen investime dhe nuk janë të ngarkueshme me TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[33] Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme:** Shëno blerjet vendore dhe importet që janë të ngarkueshme me TVSH, por që nuk e kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[34] Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme:** Shëno blerjet vendore dhe importet që konsiderohen investime të ngarkueshme me TVSH, por që nuk e kanë të drejtën e zbritjes së TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[35] Importet:** Shëno importet e ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[39] Importet investive:** Shëno importet investive të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[43] Blerjet vendore:** Shëno blerjet vendore të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[47] Blerjet investive vendore:** Shëno blerjet investive vendore të ngarkueshme me normën standarde të TVSH-së, 18%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[53] Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigohet sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[57] Fatura e borxhit të keq e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[61] Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë:** Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit për TVSH kur përcakton më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e ulët se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë. Po ashtu, sipas nenit 42 të Ligjit të TVSH-së vendos vlerën e TVSH-së së zbritshme në stoqet e mallrave me rastin e fillimit të aktivitetit ekonomik si person i tatueshëm i regjistruar për TVSH. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[65] E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me Ngarkesën e Kundërt:** Shëno të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme për blerjet e shërbimeve jashtë vendit, si dhe bartjen e detyrimit tatimor për TVSH brenda vendit tek pranuesi i furnizimit (aktualisht e zbatueshme në furnizimet e shërbimeve në lëminë e ndërtimitarisë brenda vendit) për të cilat aplikohet "Ngarkesa e Kundërt" sipas nenit 52 të Ligjit të TVSH-së. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[K1] TVSH e zbritshme me 18%:** Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (35+39+43+47+53+57+61+65) dhe i shumëzon me normën standarde të TVSH-së, 18%.

**[37] Importet:** Shëno importet që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[41] Importet investive:** Shëno importet investive që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formatimi është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[45] Blerjet vendore:** Shëno blerjet vendore që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formatimi është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[49] Blerjet investive vendore:** Shëno blerjet investive vendore që janë të ngarkueshme me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%. Formatimi është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[51] Blerjet nga fermerët (aplikimi i normës së sheshtë):** Shëno blerjet nga fermerët vendor sipas skemës së veçantë për bujqit. Këtu vendosen vetëm blerjet nga personat të cilët janë të pajisur me numër identifikues nga MBPZHR. Formatimi është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[55] Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 47 të Ligjit për TVSH, kur shuma e tatueshme dhe TVSH-ja në faturën tatimore duhet të korrigojen sipas nenit 41.1. të këtij Ligji. Formatimi është numër; nuk është rubrikë mandatore.

**[59] Fatura e borxhit të keq e lëshuar:** Shëno rastet sipas nenit 48 të Ligjit për TVSH, për faturat e borxhit të keq që lëshohen sipas nenit 43 të këtij Ligji. Formatimi është numër, nuk është rubrikë mandatore.

**[63] Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë:** Shëno rregullimin e zbritjeve sipas nenit 41 të Ligjit të TVSH-së kur përcaktohet më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme ka qenë më e ulët se sa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë. Po ashtu, sipas nenit 42 të Ligjit të TVSH-së vendoset vlera e TVSH-së së zbritshme në stoqet e mallrave me rastin e fillimit të aktivitetit ekonomik si person i tatueshëm i regjistruar për TVSH. Formatimi është numër, nuk është rubrikë mandatorë, **po ashtu në këtë rubrikë vendoset Ngarkesa e kundërt për Energjinë me normë 8%.**

**[K2] TVSH e zbritshme me 8%:** Formatimi është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (37+41+45+49+51+55+59+63) dhe i shumëzon me normën e reduktuar të TVSH-së, 8%.

**[67] Totali i TVSH-së së zbritshme me 18% dhe 8%:** Formatimi është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (K1+K2).

